L I G J
Nr.8169, datë 21.12.1996

PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1648, DATË 20.11.1996 "PËR THELLIMIN E MËTEJSHËM TË PROCESIT TË PRIVATIZIMIT TË BANKAVE TREGTARE ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese"

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet me ndryshime dekreti nr.1648, datë 20.11.1996 "Për thellimin e mëtejshëm të procesit të privatizimit të bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror" si vijon:

- Në nenin 1, në fund të fjalisë të hiqen fjalët: "... si dhe të bëhet ristrukturimi i tyre".

- Neni 2 riformulohet: "Për mbylljen e aktiviteteve jofitimprurëse, si dhe për rritjen e shpejtësisë së procesit të privatizimit të bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror, të bëhen ndryshimet e nevojshme në rrjetin ekzistues bankar shtetëror dhe në strukturat përkatëse organizative të tyre brenda datës 31.12.1996 dhe të zbatohen përfundimisht brenda datës 31.3.1997, por pa cënuar shërbimin e pagesave, shërbimin e buxhetit të shtetit dhe garantimin e depozitave në bankat tregtare me kapital tërësisht shtetëror."

- Neni 3 riformulohet: "Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë të nxjerrin rregulla dhe udhëzime të veçanta për të mos lejuar keqësimin e gjendjes financiare të bankave me kapital tërësisht shtetëror.

Kreditë e pakthyera nga persona të ndryshëm kundrejt bankave me kapital tërësisht shtetëror tej afateve të përcaktuara në marrëveshje të konsiderohen kredi të privilegjuara dhe të vihen menjëherë në ekzekutim sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile nga përmbaruesi gjyqësor me kërkesën e parë të bankës kredidhënëse."

- Neni 4 riformulohet: "Detyrimet e njohura deri tani për kreditë bankare të marra nga ish-kooperativat bujqësore, nga ndërmarrjet shtetërore, para datës 30 qershor 1992 dhe të Bankës së Bujqësisë e të Zhvillimit të konvertohen me obligacione me normë interesi (kamata) 1.5 % me afat shlyerje 20 vjet. Shlyerja e principalit (kryegjësë) përcaktohet nga Këshilli i Ministrave."

- Në nenin 7 data "30.11.1996" bëhet "15.12.1996".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1685, datë 30.12.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha